

VENDIM
Nr. 444, datë 31.7.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR DALJE
ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA IV)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza IV)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “ndërtesë”, “apartament”, bodrum” dhe “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 377 526 994.3 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 377 526 994.3 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë tre) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim për çdo pasuri, objekt shpronësimi, duhet të kërkohet dokumentacion pronësie, i rifreskuar për secilin pronar, të konfirmuar nga institucioni kompetent, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim verifikimin e kufizimeve përkatëse që mbartin kartelat e pasurive, në bazë të të cilave do të vlerësohet dhe do të bëhet procedura e ekzekutimit të këtij vendimi.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe

regjistrin aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR DALJE ELBASAN-PËRRENJAS-QAFËTHANË (FAZA IV)”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM								Totali	SHËNIME (Kufizime hipotekore barre mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqe e shpronësimit objekt banimi (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqe e shpronësimit objekt social-ekonomik (m²)	Vlerësimi me preventiv punimesh		
1	Arben	Bajram	Muçaku	2446	8/308	truall	300	248	2898	718,704.0				575.5	19777030.60	20,495,734.6	
2	Luçiano	Asim	Skura	2446	8/341	truall	210	210	2898	608,580.0				680.0	20435229.90	30,043,809.9	
3	Luçiano	Asim	Skura	2446	8/341+1-2	apartament	226				308.1	57,764.00	17,797,088.4			17,797,088.4	
4	Albana	Nevruz	Skura														
5	"Dario Group"			2446	500/3	ndëtesë	480							480.0	19123597.70	19,123,597.7	
6	"Dario Group"			2446	499/17	truall+ndëtesë	2031	1276	2898	3,697,848.0				954.0	44908506.89	48,606,354.9	
7	Agim	Hasan	Alla	2446	499/2	truall	300	277	2898	802,746.0	89.70	57,764.00	5,181,430.8	144.0	3928538.07	9,912,714.9	
8	Kosta	Pandeli	Faqolli	2446	499/4	truall	150	150	2898	434,700.0	300	57,764.00	17,329,200.0			17,763,900.0	
9	Rexhep	Rrahman	Llushi	1527	496/10	truall	234.1	234.1	260	60,866.0				481.6	22719665.38	22,780,531.4	
10	Ismete	Rrahman	Llushi														
11	Adile	Nazif	Llushi	1527	496/11-N	ndëtesë	161.2							161.2	5172162.20	5,172,162.2	
12	Ferit	Rrahman	Llushi	1527	496/14	truall+ndëtesë	216.1	216.1	260	56,186.0				390.9	10538538.90	10,594,724.9	
13	Kadife	Hashi	Llushi	1527	496/14	truall+ndëtesë	216.1	216.1	260	56,186.0				390.9	10538538.90	10,594,724.9	
14	Ilir	Sclaudin	Cota	2446	499/21	truall	164	164	2898	475,272.0				109.6	5308988.30	5,784,260.3	
15	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/3	truall	123	108.8	221	24,044.8						24,044.8	
16	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/4	truall	177	177	221	39,117.0				176.2	6146977.80	6,186,094.8	
17	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/8	truall	131	123.5	221	27,293.5	167.6	57764	9,681,246.4	130.9	5354147.60	15,062,687.5	
18	Violeta	Enver	Agolli	1063	147/8	truall	131	123.5	221	27,293.5	167.6	57764	9,681,246.4	130.9	5354147.60	15,062,687.5	
19	Eduart	Rexhep	Kushita	1063	600/21-B	bodrum	88.5							88.5	4353151.23		
20	Eduart	Rexhep	Kushita	1063	600/21-N	ndëtesë	88.5							88.5	4353151.23		
21	Eduart	Rexhep	Kushita	1063	600/21+1-2	apartament	88.5				88.5	57764	5,112,114.0			13,818,416.5	
22	Hysen	Rexhep	Kushita	1063	600/20	truall	101.2	101.2	221	22,365.2				303.6	14923694.03	14,946,059.2	
23	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55	truall	505.3	298	221	65,858.0						65,858.0	
24	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-1	njësi	88.9							88.9	4455746.23		
25	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-2	njësi	319.3							319.3	16003596.9		
26	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-3	njësi	310.3							310.3	15552509.06		
27	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-3/1	njësi	19.5							19.5	977364.02		
28	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-3/2	njësi	92							92.0	4611120.96		
29	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N-4	njësi	58							58.0	2907011.04		
30	Xhevdije	Rexhep	Zhari	1063	600/55-N+1-1	apartament	328.7				328.7	57764	18,987,026.8			18,987,026.8	
31	Ismet	Met	Alla	2446	499/8	truall	66.12	66.12	2898	191,615.8				132.24	4939356.90	5,130,972.7	
32	Fete	Xheladin	Alla														
Vlera totale																377,526,994.3	